




DPK/DPKI 01/819/13
2 faze 21.03.2013



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **12.03.2013**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-4803/11, për ztr. **Milazim Shatri** – Kryeshef Ekzekutiv në Kompaninë Rajonale të ujësjellësit “Drini i Bardhë” Pejë, **për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-4803-11, për Zyrtarin e lartë, ztr. Milazim Shatri – Kryeshef Ekzekutiv në Kompaninë Rajonale të ujësjellësit “Drini i Bardhë”, dhe njëkohësisht njëri nga personat e autorizuar të një biznesi privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-4803/11, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari të lartë, ztr. Shatri së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia, (DPK-01-715-12), pas të cilës zyrtari na ka dërguar disa shkresa zyrtare (DPKI-03-2618/12, DPKI-03-3578/12, DPKI-03 600/13), në të cilat ka përsëritur faktet se biznesi nuk është aktiv dhe kjo, sipas tij nuk do të duhej të paraqet konflikt interesi. Megjithatë, ai ka njoftuar se ka nisë procedurën për ndryshimet e nevojshme në biznes, por për faktin se numri i bashkëpronarëve është shumë i madhë (njëzetepesë), e disa prej tyre janë në botën e jashtme, i duhet kohë deri në mbledhjen e të gjitha nënshkrimeve.

Duke parë se procesi i ndryshimeve të nevojshme po zgjatë, Agjencia kundër Korrupsionit, i ka bërë edhe shkresën e dytë, sipas procedurës ligjore, që njihet me emrin “Njoftim paralajmërues” (DPK-01-218-13) me të cilin zyrtarit të lartë i është bërë e qartë se duhet të shmangët situata e konflikti të interesit brenda afatit të caktuar, përndryshe do të pasojnë edhe masat tjera sanksionuese që janë të parapara me ligj.

Ndërkohë, pas kësaj shkrese, Zyrtari i lartë, ztr. Shatri, përmes postës elektronike (e-mailit zyrtar), ka njoftuar se janë bërë ndryshimet e nevojshme në biznes, duke na e dërguar të bashkangjitur një kopje të dokumentit të lëshuar nga Agjensioni për regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03-725-13), në të cilin shihet se ztr. Milazim Shatri ka heq dore nga funksioni menaxhues në ndërmarrjen private Kooperativa bujqësore “Gurra”.

Në bazë të këtij dokumenti zyrtar, kemi konstatuar se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

